

## GJYKATA E QARKUT KLINE

C.Nr.91/03

**GJYKATA E QARKUT KLINE**, Kryetare e Trupit Gjykses, gjykatësja e EULEX-it Verginia Micheva-Ruseva, proces-mbajtës Robert Abercrombie dhe përkthyesit ndërkombëtarë në gjuhën shqipe dhe serbe Burim Bytyqi dhe Bozana Ivos, në lëndën e paditësit Malisha Perovic nga Gurakoc, tani banues në Serbi, i përfaqësuar nga avokati Dragisa Duric kundër të paditurve Alush Agushi, Ruzdi Agushi, Fadil Agushi, Sokol Elizaj dhe Rrahim Brahim Gashi, tre të paditurit e parë të përfaqësuar nga avokati Haxhi Millaku në lidhje me paditë mbi anulimin e kontratës së patundshmërisë, kthimin në posedim dhe dëmshpërblimin, pas mbajtjes së seancës gjyqësore më datë 10.08.2010, merr si në vijim

### AKT-GJYKIM

Me **APROVIMIN** e padisë së Malisha Perovic nga Gurakoc me numër letërnjoftimi 1408951933018, kontrata e transaksionit, nënshkruar në emër të Peroviq Zhivka Malisha përfaqësuar nga Ruzhdi Agushi, nga fshati Drenoc, Komuna e Klinës, bazuar në letrën e autorizimit verifikuar më datë 14.12.2004 në Gjykatën Komunale Mitrovicë me numër Vr.nr.2760/04 si shitës dhe Fadil Haki Agushin nga fshati Drenoc, Komuna e Klinës si blerës, vërtetuar më datë 15.02.2004 në Gjykatën e Qarkut Klinë me numër VR. No. 1502/2004 **DEKLAROHET E PAVLEFSHME**.

Me **APROVIMIN** e padisë së Malisha Perovic, kontrata e transaksionit, nënshkruar në emër të Fadil Haki Agushit, nga fshati Drenoc, Komuna e Klinës, si shitës dhe Rrahim Brahim Gashit nga fshati Vojnik, Komuna e Klinës, si blerës, vërtetuar më datë 27.12.2004 në Gjykatën e Qarkut Klinë me numër VR. Nr. 1538/2004, **DEKLAROHET E PAVLEFSHME**.

Me **APROVIMIN** e padisë së Malisha Perovic, kontrata e transaksionit, nënshkruar në emër të Fadil Haki Agushit, nga fshati Drenoc, Komuna e Klinës, si shitës dhe Sokol Miftar Elezaj nga fshati Gjurgjeviku I Vogel, Komuna e Klinës si blerës, vërtetuar më datë 27.01.2005 në Gjykatën e Qarkut Klinë me numër VR. Nr. 150/2005, **DEKLAROHET E PAVLEFSHME.**

Fadil Haki Agushi **URDHËROHET** të heqë dorë nga pronësia dhe të largohet nga prona e patundshme e përshkruar në fletën poseduese 505, parcela kadastrale 1809/1 e Zonës Kadastrale Drsnik, me sipërfaqje të përgjithshme prej 0.09.46 ha, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve prej ditës kur ai ka pranuar aktgjykimin. Nëse Fadil Haki Agushi dështon që të bëjë këtë ai do të dëbohet nga parcela e lartpërmendur.

Rrahim Brahim Gashi **URDHËROHET** të heqë dorë nga pronësia dhe të largohet nga prona e patundshme e përshkruar në fletën poseduese 687, parcela kadastrale 1809/4 e Zonës Kadastrale Drsnik, me sipërfaqje të përgjithshme prej 0.09.10 ha, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve prej ditës kur ai ka pranuar aktgjykimin. Nëse Rrahim Brahim Gashi dështon që të bëjë këtë ai do të dëbohet nga parcela e lartpërmendur.

Sokol Miftar Elezaj **URDHËROHET** të heqë dorë nga pronësia dhe të largohet nga prona e patundshme e përshkruar në fletën poseduese 689, parcela kadastrale 1809/5 e Zonës Kadastrale Drsnik, me sipërfaqje të përgjithshme prej 0.00.50 ha, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve prej ditës kur ai ka pranuar aktgjykimin. Nëse Sokol Miftar Elezaj dështon që të bëjë këtë ai do të dëbohet nga parcela e lartpërmendur.

Komuna e Klinës, Zyra Kadastrale, **URDHËROHET** të ndryshojë regjistrat kadastralë në përputhje me këtë akt-gjykim dhe të kthejë mbrapsht ndryshimet e bëra në regjistrat kadastralë, domethënë duke regjistruar parcelën e përmendur më lart në fletën poseduese 505, parcela kadastrale 1809/1 e Zonës Kadastrale Drsnik, me sipërfaqje të përgjithshme prej 0.19.06 ha, në emër të Malisha Zhivka Perovic.

Fadil Agushi **URDHËROHET** t'i paguajë Malisha Perovic shumën e mëposhtme:

1. 22 838.78E kompensim për dëmet materiale të shkaktuara;
2. 4 000.18E interes për periudhën duke filluar nga 29.04.2003 deri 31.07.2009;
3. Interes shtesë për të dyja shumat (22838.78E and 4000.18E) duke filluar nga 01.08.2009 deri datën kur të jetë bërë pagesa finale,
4. 1 100E shpenzimet gjyqësore;

Të gjitha të jenë paguar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita kur ky akt-gjykim të jetë pranuar nga ai.

Pjesa tjetër e kompensimit **HIDHET POSHTË**.

Padia ngritur nga Malisha Perovic kundër Alush Agushit dhe Ruzhdi Agushit për të paguar bashkarisht me Fadil Haki Agushin kompensimet për dëme në shumën prej 24 351.50E me interes nga data 01.08.2009 deri kur të jetë bërë pagesa finale, dhe 4,249.04E si interes për dëmshpërblimin (24,351.05E) interesi mbi këtë shumë fillon nga 01.08.2009 deri ditën kur të jetë bërë pagesa finale, **HIDHET POSHTË** si e pabazuar.

Fadil Agushi urdhërohet që t'i paguajë Gjykatës së Qarkut Klinë 634.20E taksa gjyqësore brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita kur ky akt-gjykim të jetë pranuar nga ai.

Kërkesat e Alush Agushit, Fadil Haki Agushit, Ruzhdi Agushit, Rrahim Brahim Gashit, Sokol Miftar Elezajt për kompensim të shpenzimeve gjyqësore **HIDHEN POSHTË** si të pabazuara.

## ARSYETIMI

### *I. Historiku*

Në kohën kur filloi fushata ajrore e NATO-s në vitin 1999 Malisha Perovic u largua nga prona e tij në Klinë, parcelë e përshkrua në Fletën Poseduese List 505, parcela kadastrale 1809/1 e Zonës Kadastrale Drsnik (më poshtë e shënuar si 'Parcela'). Parcela i ishte transferuar Fadil Haki Agushit nëpërmjet një kontrate transaksioni të datës 15.12.2004 (më poshtë e shënuar si 'Kontrata e Transaksionit') dhe e nënshkruar në emër të Malisha Perovic nga Ruzhdi Agushi (vëllai i të paditurit Fadil Agushi), në bazë të një letre të përgjithshme autorizimi (regjistruar në Gjykatën Komunale të Mitrovicës më datë

14.12.2004, Vr.nr.2760/04). Çmimi i transaksionit për Parcelën ishte 185 000 E. Kontrata e Transaksionit u regjistrua nga Gjykata e Qarkut të Klinës me numër VR. Nr. 1502/2004 më datë 15.12.2004 dhe transferta u regjistrua në Regjistrat Kadastralë të Klinës, në këtë mënyrë duke bërë Fadil Agushin pronarin e regjistruar të Parcelës.

Me anë të një kërkesë të datës 20.12.2004 Fadil Agushi kërkoi ndarjen e parcelës. Si rezultat parcela 1809/1 me sipërfaqe të përgjithshme prej 0.19.06 ha u nda në tre parcela: parcela 1809/1 me sipërfaqe prej 0.09.46 ha, parcela 1809/5 me sipërfaqe prej 0.00.50ha dhe parcela 1809/4 me sipërfaqe prej 0.09.10ha.

Parcela 1809/4 me sipërfaqe prej 0.09.10ha Fadil Agushi ia shiti Rahim Gashit nëpërmjet kontratës së transaksionit së datës 27.12.2004 e vërtetuar në GJK të Klinës me numër Vr.nr.1538/04. Parcela u regjistrua në emër të Rahim Gashit në regjistrat kadastralë.

Parcela 1809/5 me sipërfaqe prej 0.00.50ha Fadil Agushi ia shiti Sokol Elezajt përmes kontratës së transaksionit së datës 27.01.2005 e vërtetuar në GJK të Klinës me numër Vr.nr.150/05. Parcela u regjistrua në emër të Sokol Elezaj në regjistrat kadastralë.

Momentalisht parcela 1809/1 e Zonës Kadastrale Drsnik me sipërfaqe të përgjithshme prej 0.09.46ha është regjistruar në emër të Fadil Agushit.

I padituri Fadil Agushi është në posedim të parcelës 1809/1 mbi të cilën është ndërtuar një pompë benzine, i padituri Rahim Gashi është në posedim të parcelës 1809/4 mbi të cilën është ndërtuar një qendër inspektimi, dhe i padituri Sokol Elezaj është në posedim të parcelës 1809/5.

## *II. Padi*

Më datë 29.04.2003 Malisha Perovic ngriti një padi në Gjykatë për dëmshpërblim të vlerësuar nga ai në shumën prej 10 000E në muaj kuncër të paditurve Agush Agushi, Agron Agushi dhe Milazim Agushi për përdorimin e pronës së tij - parcela 1809/1 me pompën e benzines së ndërtuar në këtë parcelë, për periudhën gusht 1999 – prill 2003. Lënda është regjistruar në Gjykatë nën numrin C.nr.91/2003. Më datë 05.11.2008 ai e tërhoqi padinë kundër dy të paditurve të fundit. Ai qartësoi se emri i saktë i të paditurit është Alush Agushi dhe jo Agush Agushi. Omë datë 02.03.2009 paditësi e zgjeroni padinë

e tij edhe kundër të paditurve Ruzdi Agushi dhe Fadil Agushi. Më datë 6 prill 2009 paditësi e specifikoi kërkesën për dëmshpërblim duke kërkuar prej të paditurve bashkarisht 5000E qera mujore duke filluar nga data 1 gusht 1999 deri 31 dhjetor 1999 dhe 3000E qera mujore nga 1 janari 2000 deri ditën e akt-gjyqimit. Në fund paditësi ka specifikuar se vlerësimi tij i kërkesës për dëmshpërblim kundër të paditurve Alush Agushi, Ruzdi Agushi dhe Fadil Agushi është 24 351, 50 E për përdorim ilegal të parcelës kadastrale 1809/1 me sipërfaqe prej 0.09.46ha si dhe pompa e benzinës e cila ndodhej në atë parcelë, për periudhën 1 gusht 1999 deri 31 korrik 2009 me interesa ligjorë mbi shumën duke filluar nga 1 gushti 2009 si dhe 4 249.04E si interes për shumën kompensuese duke filluar nga 1 gushti 1999 deri 31 korrik 2009 me interesa ligjorë mbi këtë shumë duke filluar nga data 1 gusht 2009. Paditësi kërkon gjithashtu shpenzimet gjyqësore.

Më datë 6 tetor 2005 paditësi Perovic ngriti një padi në gjykatë kundër Fadil Agushit për anulimin e Kontratës së Transaksionit. Për më tepër, ai pretendonte se i padituri duhej të urdhërohej që të lironte Parcelën nën kërcënimin e përmbarimit dhe se zyra kadastrale e Klinës duhej të urdhërohej që të ndryshonte regjistrat e tyre kadastrale në lidhje me Parcelën në pajtim me akt-gjykimin. Baza për padinë ishte se Malisha Perovic kurrë nuk kishte hequr dorë vullnetarisht nga e drejta e tij e pronësisë mbi Parcel dhe se për këtë arsye Kontrata e Transaksionit ishte e pavlefshme. Tlënda u regjistrua në gjykatë nën numrin C.nr. 408/2005. Në seancën e mbajtur më datë 9 korrik 2009 paditësi e zgjeroi padinë edhe kundër dy të paditurve të tjerë Rahim Gashi dhe Sokol Elezaj duke kërkuar anulimin e transaksionit të datës 27.12.2004 vërtetuar në GJK të Klinës nën numrin Vr.nr.1538/04 nënshkruar mes Fadil Agushit dhe Rahim Gashit, si dhe për anulimin e transaksionit të datës 27.01.2005 vërtetuar në GJK të Klinës nën numrin Vr.nr.150/05 nënshkruar mes Fadil Agushit dhe Sokol Elezajt.

Për më tepër ai kërkonte që i padituri Fadil Agushi duhej të urdhërohej që të lëshonte parcelën kadastrale 1809/1 me sipërfaqe prej 0.09.46 ha regjistruar në fletën poseduese 505, ZK Drsnik, si dhe pompën e benzinës ndërtuar në këtë parcelë, i padituri Rahim Gashi duhej të urdhërohej që të lëshonte parcelën kadastrale 1809/4 me sipërfaqe prej 0.09.10h regjistruar në fletën poseduese 687, ZK Drsnik , dhe i padituri Sokol Elezaj

duhej të urdhërohej që të lëshonte parcelën kadastrale 1809/5 me sipërfaqe prej 0.00.50ha regjistruar në fletën poseduese 689, ZK Drsnik, nën kërcënimin e përmbarimit dhe se zyra kadastrale e Klinës duhej të urdhërohej që të ndryshonte regjistrat e tyre kadastrale në lidhje me Parcelën në pajtim me akt-gjykimin.

Me një vendim gjykata bashkoi lëndën c.nr.91/03 dhe c.nr.408/05 dhe lënda u procedua nën numrin c.nr.91/03.

Të paditurit Fadil Agushi, Rahim Gashi dhe Sokol Elezaj kanë kundërshtuar padinë për anulimin e kontratave të transaksionit mbi bazat se transaksionet janë bërë në mënyrë të ligjshme në bazë të letrëz së autorizimit të lartpërmendur nënshkruar nga paditësi. Ata kanë paguar shumën e plotë të blerjes duke patur plotësisht besim tek blerësi.

Përsa i përket kërkesës për dëmshpërblim të paditurit, përmes avokatit të tyre e kanë kundërshtuar këtë kërkesë duke u bazuar në faktin se ata janë pronarët e ligjshëm dhe se ata nuk kanë detyrime në lidhje me çdo lloj kompensimi për përdorim të paligjshëm të pronës kontestuese.

### *III. Historiku Procedural*

Pas ngritjes së padisë në Gjykatën e Qarkut të Klinës më datë 29.04.2003 dhe pas ngritjes së padisë për anulimin e kontratës së transaksionit në të njëjtën gjykatë më datë 6 tetor 2005, lëndët u caktuan gjykatësve raportues të cilët mbajtën disa seanca.

Paralel me procedurën civile në gjykatë, Prokurori Komunal ka trajtuar një kallëzim penal të ngritur nga Malisha Perovic në shtator 2005 kundër Ruzdi Agushit, Fadil Agushit dhe Bedri Godancit, avokat nga Klina për veprën penale të falsifikimit të dokumentit. Me vendim të datës 20.03.2006 me numër PP.nr.1861/2005 prokurori publik hodhi poshtë kallëzimin penal me arsyetimin se sjellja e të pandehurve nuk përmbante elementë të veprës penale. Paditësi e dërgoi lëndën nën vëmendjen e Departamentit të Drejtësisë, UNMIK. Pas shqyrtimit të kallëzimit penal, një Prokuror Publik Ndërkombëtar filloi ndjekjen penale kundër Ruzdi Agushit dhe Fadil Agushit në pajtim me rregulloren e UNMIK-ut 2006/6 ndryshuar nga rregullorja e UNMIK-ut 200/34 dhe 2001/2 pjesa 1.3 (e cila autorizon prokurorë ndërkombëtarë të zgjedhin dhe marrin përgjegjësi mbi hetime penale të vjetra dhe në zhvillim e sipër) për kryerjen e veprave

penale të falsifikim dokumentesh, legalizim i përmbajtjeve falso, mashtrim dhe zënie e paligjshme e pronës së patundshme të një personi tjetër. Gjatë hetimit, regjistruar nën PCIR/72/06, janë marrë dëshmitë e një numri dëshmitarësh. Me anë të një kërkesë të datës nëntor2006 Prokurori Ndërkombëtar ka kërkuar që t'i sigurohen origjinalët e kokumenteve të vërtetuara në Gjykatën Komunale të Klinës nën numrin Vr.nr. 1502/04 të datës 15.12.2004 (kontrata e transaksionit, letra e autorizimit etj.). Ai kërkoi dhe siguroi nga GJK Mitrovicë origjinalin e letrës së autorizimit vërtetuar në gjykatë më datë 14.12.2004 nën numrin Vr.nr.2760/04. Më tej i padituri Fadil Agushi i dorëzoi prokurorit origjinalin e tij të letrës së autorizimit të lartpërmendur. Qqëllimi i prokurorit ishte që të urdhëronte ekspertizë të shkrimit të dorës të nënshkrimit të letrës së autorizimit por kjo nuk u bë. Në vitin 2008 lënda penale u mbyll dhe në 2009 u kthye në zyrën e prokurorit Komunal në Pejë. Më vonë lënda u kërkuar nga gjykata dhe iu bashkangjiti dosjes civile të gjykatës si provë.

Përmes një vendimi të Gjykatës të EULEX-it duke vepruar në bazë të udhëzimeve të Kryetares së Asamblesë së Gjykatësve të EULEX-IT më datë 21.05.2009 lënda C.nr. 408/05 iu caktua Gjykatës së EULEX-it Virginia Micheva-Ruseva në Gjykatën Komunale të Klinës meqënëse u arrit në përfundimin se lënda përmbushte elementët e paraparë nga Neni 5.1 pika c (ii) dhe (iii) Ligji mbi Kompetencat (Ligji Nr. 03/L-53).

Përmes një vendimi të Gjykatës të EULEX-it duke vepruar në bazë të udhëzimeve të Kryetares së Asamblesë së Gjykatësve të EULEX-IT më datë 12.06.2009 lënda C.nr. 91/03 iu caktua Gjykatës së EULEX-it Virginia Micheva-Ruseva në Gjykatën Komunale të Klinës meqënëse u arrit në përfundimin se lënda përmbushte elementët e paraparë nga Neni 5.1 pika c (ii) dhe (iii) Ligji mbi Kompetencat (Ligji Nr. 03/L-53).

Më datë 25.06.2009 Gjykata caktoi një seancë për lëndën c.nr.408/05 dhe më datë 09.07.2009 një seancë për lëndën c.nr.91/03. Më vonë këto dy lëndë u bashkuan nën numrin c.nr.91/03 dhe pas mbajtjes së disa seancave procedura u mbyll.

#### *IV. Vlerësimi faktik dhe ligjor*

Faktet e mëposhtme janë të pakundërshtueshme në këtë lëndë. Malisha Perovic ishte pronari i pakundërshtueshem i Parcelës deri në qershor 1999, kohë kur ai u largua nga

Klina dhe iku në Serbi. Në parcelë u ndërtua një pompë benzine dhe që nga viti 1995 u menaxhua nga vëllai i paditësit– Budimir Perovic (shih vendimin e datës 14.10.1995, lëshuar nga Kuvendi Komunal i Klinës). Më vonë në të njëjtën parcelë u ndërtua dhe menaxhua qendra e inspektimit. Në vitin 1991 dy vëllezërit Perovic regjistroi një kompani për prodhim dhe furnizim “Perovici” në Gurakoc. Drejtori i kompanisë ishte Budimir Perovic, paditësi ishte zëvendës drejtori. Është gjithashtu fakt i pakundërshtueshëm se Malisha Perovic është arsimuar në fushën e mjekësisë, ka punuar si mjek dhe një vit para ngjarjeve të 1999 ai ishte kryetar bashkie i Istogut.

Nga vendi ku kishte mërguar, paditësi ngriti padi për dëmshpërblim për dëmet sepse ai mësoi se pompa e tij e benzinës ishte zënë dhe përdorur nga të paditurit Agushi. Fadil Agushi legjitimoi veten si pronari i pronës në bazë të Kontratës së Transaksionit të datës 15.12.2004 dhe e verifikoi në GJK të Klinës përmes së cilës Malisha Perovic përmes ërpfqësuesit të tij të autorizuar Ruzhdi Haki Agushi, letra e autorizimit verifikuar më datë 14.12.2004 në Gjykatën Komunale të Mitrovicës me numër Vr.nr.2760/04, ia shiti tokën e tij, parcelën kadastrale 1809/1 të Zonës Kadastrale Drsnik, me sipërfaqe të përgjithshme prej 0.19.06 ha Fadil Agushit për çmimin prej 185 000 E. Si pasojë e Kontratës së Transaksionit, Fadil Agushi është regjistruar si pronar i Parcelës në Regjistrin Kadastral të Komunës së Klinës. Më vonë Fadil Agushi kërkoi nga komuna ndarjen e Parcelës në tre parcela. Njërin prej tyre, aty ku ishte ndërtuar pompa e benzinës, e mbajti për vete, dhe dy parcelat e tjera ia shiti të paditurve Rahim Gashi dhe Sokol Elezaj.

Në vitin 2005 Malisha Perovic ngriti padi në gjykatë duke kërkuar anulimin e Kontratës së Transaksionit dhe rikthimin e titullit të pronarit. Më vonë, kur mësoi se një pjesë e Parcelës i ishte shitur Rahim Gashit dhe Sokol Elezajt, ai e zgjeroi padinë edhe kundër tyre duke kërkuar anulimin e kontratave të shitblerjeve të tyre me Fadil Agushin dhe rikthimin e pronës dhe titullit të pronarit.

Pra pyetja kryesore është nëse Malisha Perovic ka hequr dorë vullnetarisht nga e drejta pronësore mbi Parcelën dhe në mënyrë specifike, nëse ai ka nënshkruar letrën e autorizimit me anë të së cilës ai kishte autorizuar Ruzdi Agushin për të bërë Kontratën e

Transaksionit në emër të tij si dhe nëse ai ka nënshkruar deklaratën se pagesa e parcelës (185 500 E) ka përfunduar.

Fadil Agushi pretendon se ai e ka blerë parcelën përmes ndërmjetësuesit Minaver Kuqkoviq. Malisha Perovic kishte shkuar në Mitrovicë së bashku me ndërmjetësin e tij dhe avokatin Sheremet Ahmetin nga Mitrovica përpiloi kontratën. Ata gjithashtu kishin arritur marrëveshje [për çmimin prej 185 000E. Atë ditë ai kishte paguar Malishës 10 000E në prani të avokatit Ahmeti, Ruzdi Aguashi dhe Minaver Kuqkoviq. Malisha i kishte thënë se për pjesën tjetër të parave Minaveri dhe Haxhi Toska do të vinin pas tre ditësh, kur supozohej që ai të paguante 50 000E. I padituri Fadil Agushi spjegov se ai nuk kishte hyrë në gjykatën e Mitrovicës por se këtë e kishte bërë vëllai i tij Ruzdi Agushi. Ai kishte qëndruar jashtë gjykatës së bashku me Osman Halitin dhe Ahmet Malën, të dy nga Gurakoci dhe e njihnin Perovic. Që të dy kanë konfirmuar se personi i cili kishte ardhur në Mitrovicë për të firmosur letrën e autorizimit ishte Perovici. E gjitha kjo kishte ndodhur pas orës 12.00 të asaj dite. I padituri deklaroi gjithashtu se paditësi është i njëjti person i cili nënshkroi letrën e autorizimit në GJK të Mitrovicës. I padituri deklaroi se ai e ka paguar çmimin e parcelës në këste, të fundit në 2006. Ai nuk ka marrë asnjëherë ndoënj dokument nga paditësi ku thuhet se ai ka marrë paratë. Sipas tij pompa e benzinës ishte shembur nga paditësi i cili mori gjithçka dhe e dërgoi në Serbi, dhe pompa e benzinës u dogj krejtësisht.

Këto deklaratat janë kundërshtuar nga Malisha Perovic, i cili vazhdimisht ka mohuar se ka autorizuar dikë që të shesë pronën e tij. Përsa i përket Parcelës ai spjegov se në fund të gushtit 1999 ai është takuar me Latif Kryeziun në Mal të Zi për të diskutuar mbi pompën e benzinës, meqënëse Kryeziu kishte disa në Kosovë. Ata diskutuan mbi mundësinë që Perovic t'ia jepte pompën me qira Kryeziut dhe të ndanin fitimin. Më vonë Kryeziu e thirri dhe i tregoi atij se pompa e benzinës ishte zënë nga Alush Agushi, një gjeneral i UÇK-së. Më datë 14.12.2004 ai spjegov se kishte qenë në një restorant në Kraljevo, Serbi, pastaj mori fitimet e pompës së benzinës të cilën e kishte në Kraljevo, dhe i çoi në bankë dhe u kthye në të njëjtin restorant ku qëndori me shokë deri vonë. Në lidhje me pompën e benzinës paditësi deklaroi se në atë rajon nuk kishte pompa benzine të tjera dhe se fitimi ishte shumë i lartë. Ai fitonte qindra mijëra DM.

Të paditurit Sokol Elezaj dhe Rahim Gashi e kundërstojnë padinë duke deklaruar se ata e kanë blerë lëndën në mënyrë legale.

Siç është përmendur më lart gjykata ka kërkuar nga GJK Klinë origjinalin e letrës së autorizimit dhe origjinalin e kontratës së transaksionit nga GJK Klinë, por mori përgjigje se origjinalët janë marrë nga prokurori ndërkombëtar për nevojat e hetimit penal kundër vëllezërve Agushi. Meqënëse gjykata nuk mund të gjente menjëherë dosjen penale lëshoi një vendim për kryerjen e ekspertizës së shkrimit të dorë më datë 25.06.2009 për të ekzaminuar nënshkrimin e letrës së autorizimit dhe për t'iu përgjigjur pyetjes nëse apditësi e ka nënshkruar atë. Ekzaminimi është kryer nga Znj.Nedire Ibrahimimi, eksperte në Laboratorin e Forensikës, Ministria e Punëve të Brendshme, Prishtinë. Në fund ekspertja nuk arriti të merrte një rezultat për arsye se nënshkrimi i kontestuar ishte dftokopje e keqe dhe ajo nuk mund të identifikonte ndonjë karakteristikë individuale.

Në nëtor 2009 gjykata i gjeti dosjet penale në zyrën e prokurorit publik komunal në Peja/Pec dhe mes dokumenteve ishin dhe tre origjinalët e letrës së autorizimit të kontestuar. Më datë 3.12.2009 gjykata lëshoi një urdhër të dytë për ekspertizë grafologjike e cila duhej të kryhej mbi origjinalin e nënshkrimit në fjalë. Eksperti kishte për detyrë të krahasonte mostra të stilit të lirë të nënshkrimit të Perovic (një kopje të kartës për lëshimin e letërnjoftimit të Malisha Perovic e cila përmban nënshkrimin e tij bërë me shkronja cirilike, e datës 19.08.1997, origjinalin e letrës së autorizimit, e datës 20.09.2005, origjinalin e kërkesës së datës 20.04.2003, origjinalin e një thirrjeje zyrtare të datës 10.04.2007 dhe një zarf bashkangjitur thirrjes, të gjitha të nënshkruara nga Perovic në shkronja cirilike), 50 nënshkrime eksperimentale të nënshkrimit të Perovic në shkronja latine, 16 nënshkrime eksperimentale të nënshkrimit të tij në shkronja cirilike dhe 16 shkronja latine të shkruara nga ai) në nënshkrimit të letrës së autorizimit të datës 14.12.2004 për dhënësin e autorizimit ( "davaoc punomocja"). Më datë 28.01.2010 i njëti ekspert grafologjik parashtrroi një raport sipas të cilit nënshkrimi në fjalë mund të jetë bërë nga paditësi. Ekspertja Znj.Nedire Ibrahimimi e konfirmoi gjithashtu konkluzionin e saj gjatë një seance gjyqësore mbajtur më datë 10.11.2009 dhe specifikoi se ai kishte arritur në këtë konkluzion në bazë të ngjashmërive të dy nënshkrimeve dhe se ajo nuk kishte krahasuar ndryshimet. Në lidhje me ndryshimet eksperja sqaroi se ajo kishte gjetur

të tilla dhe se për këtë arsye kishte arritur në përfundimin se paditësi *mund* të jetë i njëjti person i cili kishte bërë nënshkrimin në fjalë në letrën e autorizimit por ajo nuk është përgjigjur se ai ishte i njëjti person.

Pas kërkesës së paditësit dhe duke marrë parasysh paqartësinë e raportit të dorëshkrimit të ekspertës. Znj Nedire Ibrahimimi e cila nuk është përgjigjur qartë në pyetjen e gjykatës nëse paditësi ka nënshkruar autorizimin që mban datën 14.12.2004 dhe që është verifikuar në GJK Mitrovica nën Vr.nr.2760/04, gjykata ka urdhëruar një ekspertizë tjetër të grafologjisë me të njëjtën detyrë që duhet të kryhet nga një ekspert ndërkombëtar. Gjykata ka zgjedhur një ekspert me eksperiencë në krahasimin e nënshkrimeve të nënshkruara në shkronja në alfabetin Latin dhe Cirilik. Eksperti i njëjtë ka kryer disa raporte me detyra të ngjashme për Agjencinë Kosovare të Pronës. Eksperti Z. Ilia Iliev e ka paraqitur raportin e tij më 2 Korrik 2010, zyrtarisht të përkthyer në gjuhën Angleze. Sipas konkluzionit nënshkrimet e nënshkruara në autorizimin e datës 14.12.2004 nuk janë nënshkruar nga i njëjti person i cili i ka nënshkruar nënshkrimet eksperimentale (paditësi). Gjatë seancës gjyqësore eksperti i ka shpjeguar metodat e tij të ekzaminimit dhe ka specifikuar që ai ka zbuluar një grup ndryshimesh sa i përket nivelit të rrjedhshmërisë, shpejtësisë së shkrimit dhe koordinimit, shtrirjes vertikale dhe horizontale, kombinimit të shkronjave dhe konfiguracioneve dhe kjo ishte e mjaftueshme për përfundimin që nënshkrimet e ekzaminuara dhe nënshkrimet mostër të marra nga Malisha Perovic kanë reflektuar shkrimin personal dhe zakonet motorike të dy individëve të ndryshëm. Nënshkrimet mostër kanë reflektuar një nivel më të lartë të rrjedhshmërisë dhe shpejtësisë së shkrimit. Eksperti gjithashtu ka gjetur dallime fundamentale në nënshkrimin e shkronjave "P", "e", "E", "R", "O", "V", "T", "C", "M", "A", "L", "S". Në bazë të kërkesës së drejtuar zyrës së regjistrimit civil të Komunës së Istogut gjykata e ka marrë kartelën për lëshimin e letërnjoftimit të Malisha Perovic të pranuar si provë nga gjykata \*(si në origjinal-përkthyesi).

Sipas kartelës për lëshimin e letërnjoftimit Malisha Perovic ka lindur më 14.08.1951 dhe ka numrin e amzës 1408951933018; letërnjoftimi i tij është lëshuar në Istog më 19.08.1997 me numrin e regjistrimit 64448, numri serik CP10505718. Në dosjen e lëndës penale është e bashkangjitur një kopje e letërnjoftimit të Perovic-it dhe ajo

përmban të njëjtat shënime sa i përket shënimeve në kartelën për lëshimin e letërnjoftimit.

Sipas autorizimit të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Mitrovicë më 14.12.2004 nën Vr.nr.2760/04 dhe në bazë të cilit është nënshkruar dhe verifikuar kontrata e transaksionit në GJK në Klinë më 15.12.2004 nën Vr.Nr.1502/2004 numri i letërnjoftimit të Malisha Perovic është 23450 . Autorizimit të verifikuar në GJK në Mitrovicë i bashkëngjitet një kopje e letërnjoftimit të personit i cili e ka verifikuar nënshkrimin e tij në të. Sipas tij Malisha Perovic ka numrin e amzës 1301957932016 dhe numri i letërnjoftimit të tij është 23450, numri serik CP1472664 i lëshuar më 14.08.1996. Për paraqitje të plotë duhet të shtohet edhe që numri i amzës (më tej NA) është numër unik identifikuar që i caktohet në lindje çdo personi të ish Jugosllavisë. Kjo ka filluar më 31.12.1976 me Ligjin mbi numrin e amzës (GZ e RSFJ, Nr. 58/76) dhe kjo është zbatuar për të gjithë qytetaret e lindur atëherë dhe gjallë në atë kohë, dhe ende ka qenë në përdorim në Kosovë në 2003. Numri përbëhet prej 13 shifrave të formuara në 6 grupe, të përshkruara detajisht në nenin 3 të Ligjit mbi numrin e amzës, ku dy shifrat e parë janë dita e lindjes, dy shifrat në vijim –muaji i lindjes, tri shifrat në vijim-tri shifrat e fundit të vitit të lindjes, dy shifrat në vijim-regjioni politik i lindjes, tri shifrat në vijim-numri unik i cili gjithashtu identifikon personin si mashkull apo femër (000-499 janë numrat për mashkull, 500-999 për femër), dhe shifra e fundit është një checksum që llogaritet duke përdorur formulë të veçantë. Autorizimi i kontestuar dhe kopja e letërnjoftimit e bashkëngjitur me të ka shënime që nuk përputhen me shënimet personale të paditësit. Në bazë të NA 1301957932016 mund të përfundohet që personi i cili e ka nënshkruar autorizimin në fjalë është një mashkull i lindur më 13.01.1957 në regjionin e Pejës dhe që jeton në Klin Polje. Paditësi ka lindur më 27.09.1934 në Gjurakoc, Istog, dhe gjithashtu së pari është regjistruar në Pejë, dhe është e qartë që ai nuk është personi i cili e ka nënshkruar autorizimin në fjalë. Krahasimi i thjeshtë i fotografive të letërnjoftimit të Perovic-it dhe letërnjoftimit të bashkëngjitur me autorizimin tregon që personi i cili e ka identifikuar vetën me këtë letërnjoftim përpara zyrtarit të regjistrimit në GJK në Mitrovicë dhe ka verifikuar nënshkrimin e tij në autorizim nën Vr.nr.2760/04 më 14.12.2004 është një person tjetër, jo paditësi.

Sa i përket padisë për kompensim më 9 Korrik 2009 gjykata ka urdhëruar një ekspertizë financiare me detyrë që të jepet përfundimit se sa ka qenë qiraja mujore në treg për pompën e kontestuar të benzinës nga 1 Gushti 1999. Eksperti i caktuar prof. Aziz Berisha nga Prishtina, pas analizës së detajshme të ardhurave të pompave të ngjashme të benzinës në 10 vitet e fundit, dhe gjithashtu pas marrjes parasysh të shënimeve zyrtare për qarkullimin e realizuar nga Fadil Agushi që nga 01.07.2000 (kur të gjitha bizneset në Kosovë janë obliguar që të paguajnë një taksë paushall), ka përfunduar që qiraja mujore në treg për pompën e kontestuar të benzinës për periudhën 1.08.1999 deri në 31.07.2009 (data kur raporti është paraqitur nga eksperti) është 24.351.50 E. Kamata mujore mbi këtë shumë duke filluar nga data kur është ngritur padia deri në përgatitjen e raportit është 4.242.54 E. Gjatë seancës së mbajtur më 10.11.2009 eksperti i konfirmoi përfundimet e tij.

Dokumentet e shkruara të bashkangjitura në dosjen penale janë pranuar si provë në lëndën civile. Janë disa dokumente të rëndësishme për këtë çështje. Më 2 Shtator 1999 Budimir Perovic në rolin e tij të drejtorit të PPPU Perovici nga Gjurakoci ka autorizuar Latif Kryezijun që të përdorë pompën e benzinës dhe stacionin e inspektimit në Klinë. Paditësi gjithashtu ka paraqitur kontratën Nr. 1910930458-5 të datuar 19.03.2004 të nënshkruar nga ai në rolin e drejtorit të Peroctan d.o.o. Ratina, Kraljevo dhe Raiffeisen Bank Beograd sipas të cilës Perovic ka marrë kredi nga banka në shumë prej 180 000 E për qëllime investimi dhe me afat 4 vjeçar për të kthyer kredinë. Ai gjithashtu ka paraqitur shënime bankare të lëshuara nga banka Comerciale në Kraljevë të datuara 14.12.2004 dhe 15.12.2004 sipas të cilave Perovic në këto data ka transferuar të holla në llogarinë bankare të kompanisë Peroctan, Ratina. Sipas deklaratave të Perovic ai i ka bërë transferimet para kohës së drekës.

Duke analizuar provat e mbledhura dhe më saktësisht: mospërputhjet në shënimet e letërnjoftimit origjinal të Perovic dhe shënimet e letërnjoftimit të bashkangjitur me autorizimin në fjalë, duke përfshirë mospërputhjet në dy fotografitë e ngjitura në dy letërnjoftimet, dhe përfundimin e ekspertit ndërkombëtar të dorëshkrimit që paditësi nuk e ka nënshkruar autorizimin e kontestuar Vr.nr.2760/04 më 14.12.2004 gjykata përfundon që Ruzhdi Haki Agushi nuk ka qenë i autorizuar si duhet që të nënshkruar Kontratën e

Transaksionit në pajtim me nenin 89 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (GZ 29/78) (LMD). Sipas arsyesimit të njëjtë, në këtë deklaratë nuk mund të mbështetemi për të përfunduar që Malisha Perovic ka pranuar shumë nga transaksioni i bërë nga Fadil Agushi. Ky përfundim nuk mund të kundërshtohet nga deklaratat e të paditurit Fadil Agushi i cili kurrë më parë nuk e ka njohur Perovic-in e as nuk e ka parë atë duke nënshkruar autorizimin e as duke e pranuar shumë nga transaksioni, dhe i cili i ka besuar njerëzve të tjerë që ai i ka përmendur, Osman Haliti dhe Ahmet Mala. Gjatë kohës kur autorizimi i kontestuar është nënshkruar në Mitrovicë (rreth kohës së drekës sipas të paditurit Fadil Agushi) paditësi ka qenë në Krlevë duke transferuar të holla në bankë (shih shënimet bankare). Nuk ka prova që mbështesin që Kontrata për Transaksion është nënshkruar me dashje apo pjesëmarrje të Perovic-it. Gjykata i jep besim raportit të ekspertit të dorëshkrimit Z. Ilia Iliev i cili pas ekzaminimit të thellë të dallimeve të dy nënshkrimeve (atij të kontestuar dhe mostrave të nënshkrimeve) ka arritur në përfundim të qartë që paditësi nuk e ka nënshkruar autorizimin e kontestuar. Raport i ekspertit Nedire Ibrahimimi nuk është i qartë; atij i mungon shpjegimi i metodologjisë së përdorur për të arritur përfundimin. Fotografitë e bashkangjitura në raport që përfaqësojnë shkronjat e rritura "P", "E", "C", "L", "S" dhe "A" të nënshkrimit të kontestuar dhe nënshkrimet mostër nuk tregojnë në të vërtetë ndonjë ngjashmëri në dy nënshkrimet. Përfundimi i ekspertit Iliev gjithashtu mbështetet me prova tjera në dosje të lëndës – mospërputhjet në shënimet e dy letërnjoftimeve dhe fotografive të ngjitura në to. Për më tepër në këtë çështje gjykata ka refuzuar dëgjimin e dëshmitarëve sa i përket faktit nëse Perovic ka qenë prezent në Mitrovicë dhe ka nënshkruar autorizimin e kontestuar, sa i përket kësaj çështje përgjigja është dhënë nga eksperti i dorëshkrimit Iliev. Gjithashtu duhet shtuar që vlefshmëria e një kontrate nuk mund të provohet me dëshmitarë pasi që dokumentet me shkrim dhe ekspertiza kanë fuqi më të madhe provuese.

Me pak fjalë, prandaj mund të përfundohet që Kontrata mbi Transaksionin nuk ka qenë marrëveshje detyruese për shitje të ngastrës, pasi që nuk është vërtetuar që Malisha Perovic, si pronar ligjor i ngastrës, ka qenë palë miratuese e kontratës në fjalë. Kontratës mbi Transaksionin prandaj i mungon dashja miratuese e njëres prej palëve kontraktuese dhe nuk është lidhur asnjë marrëveshje detyruese (neni 26 i LMD). Kontrata mbi

Transaksionin prandaj shpallet e pavlefshme dhe e anuluar në pajtim me nenin 103 para. 1 të LMD. Sipas nenit 104 të LMD secila prej palëve kontraktuese do ti kthej tjetrës atë që ka marrë në bazë të kontratës.

Fakti që i padituri ka paguar çmimin për pronën nuk është relevant për çështjen e pronës. Ai mund të pretendojë që ti kthehen të hollat nga personi i cili i ka marrë. Është e qartë që i padituri ka qenë i përfshirë si viktimë e një skeme kriminale që ka pasur qëllim përfitimin e të hollave nëpërmes mashtrimit. Kontrata mbi transaksionin është autentike pasi që është verifikuar në gjykatë, por ajo nuk ka asnjë efekt ligjor pasi që personi i cili e ka nënshkruar nuk ka qenë i autorizuar nga pronari i vërtetë i pronës dhe ai nuk ka mundur ti transferojë të drejtat mbi pronën të cilat kurrë nuk i ka pasur. Me fjalë të thjeshta autorizimi ka qenë fals.

Sa i përket kërkesës për anulimin e kontratave vijuese mbi transaksione të lidhura në mes të Fadil Agushit si shitës dhe Rahim Gashit dhe Sokol Elezajt si blerës mund të përmendet që këto dy kontrata nuk ia kanë bartur të drejtën e pronësisë blerësve.

Retroaktiviteti për t'u kthyer në kushtet e mëparshme në marrëdhëniet në mes të palëve kontraktuese (Agushi-Perovic) ka ndikim në palët e treta. Blerësit në vijim kanë "fituar" të drejtat në bazë të një kontrate nule (diçka që nuk ekziston në sferën ligjore) dhe për këtë arsye ata nuk kanë asnjë të drejtë mbi pronën. Kjo është pasojë e rregullës që askush nuk mund të transferoj më shumë të drejta se që ka. Të drejtat e pronësisë së palëve të treta dështojnë pavarësisht nga fakti se a kanë qenë ata në dijeni për pavlefshmërinë e kontratës apo jo. Edhe pse Perovic nuk është palë në këto dy kontrata sipas nenit 109 të LMD ai, në rolin e një personi të interesuar, mund të pretendoj pavlefshmërinë e tyre. Pasi që Kontrata mbi Transaksionin në këtë mënyrë është anuluar, edhe dy kontratat vijuese mbi transaksione gjithashtu duhet të anulohen. Të paditurit Rahim Gashi dhe Sokol Elezaj urdhërohen që të dorëzojnë posedimin dhe të largohen nga ngastra. Zyra Kadastrale e Komunës së Klinës urdhërohet që të kthej mbrapsht librat e saj kadastrale dhe kështu të rivendos Malisha Perovic si pronar ligjor të ngastrës:

Padia për kompensim:

Paditësi ka deklaruar që të paditurit Alush Agushi, Fadil Agushi dhe Ruzhdi Agushi e kanë përdorur ngastrën në mënyrë të paligjshme prandaj ata duhet të obligohen që ti

paguajnë atij bashkarisht kompensimin prej 24 351 50 E për periudhën prej 1 Gushtit 1999 deri në 31.07.2009 me kamatë që fillon prej 1 Gushtit 2009 dhe shumën prej 4 249 E si kamatë e llogaritur për periudhën 1 Gusht 1999 deri në 31 Korrik 2009. Padia është paraqitur në gjykatë më 29.04.2003. Të paditurit nëpërmes përfaqësuesit të tyre ligjor kanë kundërshtuar padinë duke deklaruar që ata nuk kanë borxh kurrfarë kompensimi për përdorimin e paligjshëm të pronës së kontestuar pasi që ata janë pronarët ligjorë. I padituri Fadil Gashi është ftuar në mënyrë të rregullt në seancë për herë të parë në 2009 kur paditësi ia ka drejtuar padinë për kompensim atij dhe vëllait të tij Ruzhdiut. Megjithatë më 16.12.2005 ai është paraqitur përpara Prokurorit Publik Komunal në Pejë i cili e ka informuar atë për kallëzimin penal të Malisha Perovic kundër tij (shih aktvendimin e prokurorit publik të datës 20.03.2006, PP nr. 1861/2005). Është e pakontestueshme që pas ngjarjeve në Qershor 1999 Fadil Agushi e ka uzurpuar ngastërn dhe e ka përdorur pompën e benzinës dhe stacionin për inspektim (shih deklaratën e tij të dhënë në seancën e mbajtur më 15.01.2009). Vëllai i tij Ruzhdi Agushi ka punuar në pompë të benzinës si punonjës dhe ka marrë rrogë për këtë. Të ardhurat nga pompa e benzinës i ka marrë i padituri Fadil Agushi. Sa i përket të paditurit Agush Agushi nuk ekziston asnjë provë që do të zbulonte ndonjë përfshirje të tij në uzurpimin e paligjshëm të ngastrës. Më 15.12.2004 ngastra është transferuar në emër të Fadil Agushit. Më 27.12.2004 ai ia ka shitur një pjesë të saj së bashku me stacionin për inspektim Rahim Gashit dhe më 27.01.2005 një pjesë tjetër (vetëm tokë) Sokol Elezajt. Ai ka vazhduar të përdorë pjesën e tij të ngastrës dhe pompën e benzinës deri tani. Gjithashtu është e pakontestueshme që pas ngjarjeve në Qershor 1999 Perovic nuk ka mundur të kthehet në Klinikë dhe të vazhdojë të përdorë ngastrën për arsye sigurie. Për këtë arsye në Gusht 1999 ai e ka autorizuar Latif Kryezijun që të përdorë pompën e benzinës dhe stacionin e inspektimit si rezultat i një marrëveshjeje në mes atyre dyve. Perovic është dashtë të merr gjysmën e të ardhurave të stacionit pasi që Kryeziju do të mbulonte shpenzimet dhe do të drejtonte biznesin. Në Shtator ai ia ka dërguar një letër autorizimi me shkrim Kryezijut. Ky i dyti e ka kontaktuar atë duke thënë që pompa e benzinës tashmë është uzurpuar nga familja Agushi dhe që ata nuk e lejojnë atë që të merr posedimin (shih deklaratën e Perovic të dhënë në seancën e mbajtur më

03.12.2008). Nga këto fakte mund të përfundohet që Fadil Agushi ka uzurpuar ngastrën në mënyrë të paligjshme duke përfshirë pompën e benzinës nga Gushti 1999 deri më 15.12.2004. Si uzurpuesi i vetëm i ngastrës ai gjithashtu nuk e ka lejuar personin e autorizuar të paditësit, Latif Kryezijun, që të fillojë të drejtojë pompën e benzinës në emër të paditësit. I padituri Fadil Agushi e ka ndaluar të paditurin nga përdorimi i pompës së benzinës dhe kështu i ka shkaktuar atij dëme materiale – fitim të humbur. I padituri Fadil Agushi e ka ditur që ai nuk është pronarë i ngastrës dhe i pompës së benzinës dhe që ai nuk ka pasur asnjë arsye ligjore që ti përdorë ato por megjithatë ai ka vazhduar të drejtojë këtë biznes dhe të mbledhë fitimin nga shitja e benzinës edhe pasi që ai është informuar nga prokurori për kallëzimin penal të Perovic. Sipas nenit 154 para. 1 të Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve (LMD, GZ e RSFJ 29/78) kush i shkakton tjetrit dëmin ka për detyrë ta kompensojë, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij.

Sipas nenit 155 para. 1 të LMD Dëmi është pakësim i mjeteve shoqërore, respektivisht i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe parandalimi i shtimit të tyre (përfitimi i munguar). Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia. (neni 158 i LMD). Sipas nenit 186 të LMD Detyrimi i kompensimit të dëmit konsiderohet se rrjedh për pagesë që nga momenti i shkakimit të dëmit. Gjatë vlerësimit të shumës së perfitimit të munguar merret në konsiderim fitimi ka mundur të pritej në mënyrë të bazuar sipas procesit të rregullt të sendeve ose sipas rrethanave të veçanta ndërsa realizimi i të cilave është penguar nga veprimi i dëmtuesit ose nga ometimi. (neni 189 para. 3 i LMD). Para se të arrijë përfundimin sa i përket vlerave të padisë gjykata duhet të përmendë disa përfundime sa i përket pranueshmërisë së saj. Sipas nenit 376 të LMD Kërkesa e shpërblimit të dëmit të shkaktuar parashkruhet për tre vjet nga data kur i dëmtuari ka mësuar për dëmin dhe për personin që e ka bërë dëmin. Sidoqoftë kjo kërkesë parashkruhet për pesë vjet nga data kur është krijuar dëmi. Kërkesa e shpërblimit të dëmit të krijuar nga cenimi i detyrimit kontraktues parashkruhet për kohën e caktuar për parashkrimin e këtij detyrimi. Sidoqoftë, një padi e tillë do të skadojë pesë vite pas ndodhjes së dëmit apo humbjes. Paditësi ka paraqitur padinë për kompensimin e dëmit të shkaktuar duke filluar nga Gushti

1999, më 29.04.2003 kundër të paditurit të parë Alush Agushi. Padia për kompensim kundër Fadil Agushit dhe Ruzhdi Agushit është paraqitur më 02.03.2009, 10 vite pas fillimit të humbjeve të shkaktuara. Disa fakte do të përmenden sa i përket kësaj. Së pari, dihet mirë që gjykatat në Kosovë kanë ndërprerë punën pas ngjarjeve në 1999 dhe kanë filluar të punojnë përsëri më 1 Janar 2000. Paditësi ka jetuar jashtë Kosovës dhe është logjike që në një situatë të pasluftës ai si Serb e ka pasur shumë vështirë që të dijë se kush në të vërtetë e ka uzurpuar pronën e tij. Gjatë hetimeve penale të kryerja nga Prokurori Publik Komunal në Pejë kundër të paditurve Fadil dhe Ruzhdi Agushi paditësi nuk është ftuar e as nuk është informuar për hetimet. Ai vetëm është informuar për aktvendimin e prokurorit për hedhjen e kallëzimit penal. Më 6 Tetor 2005 ai ka paraqitur padi për anulimin e kontratës mbi transaksionin ashtu që gjykata e pranon që nga kjo datë i padituri e ka ditur se kush e ka uzurpuar pronën e tij. Gjykata është e mendimit që për paditësin kanë ekzistuar pengesa të pakapërcyeshme në kuptim të nenit 383 të LMD duke marrë parasysh luftën dhe situatën e pasluftës gjatë të cilës periudha e parashkrimit nuk ka rrjedhur. Kjo ka të bëjë me periudhën prej Qershorit 1999 deri më 01.01.2000 (kur janë rihapur gjykatat) dhe prej 01.01.2000 deri më 06.10.2005 gjatë të cilës kohë për paditësin ka qenë praktikisht e pamundur që të vijë në vendndodhje në Klinë dhe të kontrollojë se kush është duke e përdorur pompën e benzinës. Prandaj gjykata gjen që padia për kompensim të dëmeve materiale është paraqitur brenda pesë viteve të periudhës së parashkrimit të paraparë në nenin 376 para.2 të LMD, prandaj është e pranueshme. Sa i përket vlerave, i padituri Fadil Agushi e ka ditur që ngastra dhe pompa e benzinës e ndërtuar në të nuk kanë qenë pronë e tij por ai sidoqoftë i ka uzurpuar ato duke filluar të përdorë pompën e benzinës për përfitim të tij që nga Gushti 1999. Gjykata konsideron që për periudhën 15.12.2004 (kur ai ka transferuar pronësinë e ngastrës së bashku me ndërtesat në emër të tij)-14.12.2005 (kur ai është informuar nga prokurori për kallëzimin penal të Perovic) Fadil Agushi nuk i ka shkaktuar qëllimisht dëm paditësit pasi që nuk ka prova në dosje që do të zbulonin që ai e ka ditur që transaksioni është mashtrues, respektivisht që autorizimi është fals. Pas 14.12.2004 ai ka shkaktuar dëme nga neglizhenca pasi që ai e ka ditur që ai nuk e ka blerë tokën dhe pompën e benzinës nga pronari i vërtetë por e ka pranuar këtë fakt dhe ka vazhduar ti përdorë lokalet kundër

dëshirës së Perovic. Prandaj, Fadil Agushi do të obligohet që ti paguaj Malisha Perovic 22 838,78 E kompensim për dëmet materiale të shkaktuara nga përdorimi i paligjshëm i ngastrës dhe pompës së benzinës në të për periudhat 01.08.1999 – 15.12.2004 dhe 14.12.2005 – 31.07.2009 (data kur është përgatitur raporti i ekspertit financiar). Fadil Agushi do të paguaj shumën së bashku me kamatë 4000.18 E të llogaritur për këtë shumë duke filluar nga 29.04.2003 (kur padia është paraqitur në gjykatë) deri më 31.07.2009. Të dy shumat do të paguhen me kamatë duke filluar nga 01.08.2009 derisa të bëhet pagesa përfundimtare. Padisa sa i përket pjesës tjetër të shumës së kërkuar, diferenca në mes të 24 351.50 E dhe 22 838.78 E dhe në mes të 4249.04 dhe 4000.18 E do të refuzohet si e pabazë.

Padia kundër Alush Agushit dhe Ruzhdi Agushit do të hedhet poshtë pasi që paditësi nuk ka vërtetuar që ata në mënyrë të paligjshme kanë uzurpuar ngastrën dhe pompën e benzinës. Është vërtetuar që Ruzhdi Agushi ka punuar në pompë të benzinës si punonjës i Fadil Agushit dhe ka marrë rrogë nga ai. Prandaj, ai nuk i ka shkaktuar dëme Perovic-it. Sa i përket Alush Agushit nuk ka asnjë provë që ai ka qenë në ndonjë mënyrë i involvuar në uzurpimin e paligjshëm të pronës.

#### V. Shpenzimet e Gjykatës

Pasi që paditë janë aprovuar, të paditurit nuk kanë të drejtë për kompensim të shpenzimeve të tyre. Përfaqësuesi i paditësit pretendon kompensim për shpenzimet e gjykatës. Ato janë bërë për dy ekspertiza, 200 E janë paguar për ekspertin financiar dhe 400 E për ekspertin e dorëshkrimit. Shpenzimet e avokatit do të kompensohen sipas tarifës së avokatit në shumë prej 500 E. Pasi që taksa e gjykatës për dy paditë nuk është paguar, gjykata do të urdhërojë që të paditurit të ja paguajnë atë gjykatës. I padituri Fadil Agushi do të paguaj 500 E për padinë për anulim të kontratës dhe 134.20 E për padinë për kompensim.

Sic u deklarua më lart, sipas nenit 143.1 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, është vendosur në pajtim me dispozitivin e këtij vendim.

## MJET JURIDIK

Palët mund të kërkojnë rishqyrtim të këtij aktgjykimi nëpërmes Gjykatës Komunale në Klinë drejtuar Gjykatës së Qarkut në Pejë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita kur kopja e aktgjykimit i është dorëzuar palës përkatëse.

Gjykata Komunale në Klinë

C.Nr. 91/2003

22.10.2010

Përpiluar në anglisht

si gjuhë e autorizuar

Gjykatësja Kryesuese

Verginia Micheva-Ruseva